

PERSPEKTIVA E PROGRAMIT “DOGANË DHE SHPEDICION”, NIVELI (BACHELOR)

Programi “Doganë dhe Shpedicion” në Kolegjit “Pjetër Budi” ofron një perspektivë shumë të favorshme për studentët, duke i përgatitur ata për një treg pune që po rritet vazhdimisht si në Kosovë ashtu edhe në rajon edhe më gjerë. Rritja e sektorit të tregtisë ndërkombëtare, liberalizimi i tregjeve, zhvillimi i logjistikës dhe zgjerimi i kompanive të transportit kanë krijuar një kërkesë të qëndrueshme për profesionistë të kualifikuar në doganë, shpedicion dhe menaxhim logjistik. Studentët që përfundojnë këtë program fitojnë njohuri teorike dhe praktike për procedurat doganore, dokumentacionin dhe transportin ndërkombëtar, transportin multimodal, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe legjislacionin përkatës, duke i bërë ata konkurrues dhe të kërkuar në treg.

Në aspektin profesional, të diplomuarit tanë kanë mundësi të gjera punësimi në agjenci doganore, kompani shpedicioni, terminale doganore, operatorë apo kompani logjistikë/e, kompani transporti, kompani prodhuese dhe importuese, institucione shtetërore, sigurime transporti, si dhe në organizata ndërkombëtare që merren me tregti dhe logjistikë. Shkathtësitë praktike që zhvillohen në program nga lëndët: Shpedicioni Ndërkombëtar, Transporti Ndërkombëtar, Sistemi Doganor, Njohja e Doganore e Mallrave, E Drejta Doganore, Logjistika dhe Zingjiri Furnizues, Sistemet e Aplikuara në Doganë dhe Shpedicion dhe lëndët praktike semestrale: Punë Praktike në Doganë dhe Punë Praktike në Shpedicion, si përdorimi i sistemeve elektronike doganore, vlerësimi i mallrave, klasifikimi tarifor, planifikimi logjistik dhe menaxhimi i dokumenteve të transportit e rrisin në mënyrë të drejtpërdrejtë punësueshmërinë e studentëve dhe aftësinë e tyre për t’u përshtatur me kërkesat moderne të sektorit përkatës.

Perspektiva afatgjatë e studentëve është po ashtu shumë premtuese, pasi sektori i doganave, shpedicionit, tregtisë së jashtme, logjistikës, Transportit Ndërkombëtar po përjeton transformim teknologjik, ku kërkohen profesionistë që zotërojnë njohuri në digjitalizimin e procesëve, siguri të zinxhirit të furnizimit, standarde ndërkombëtare të transportit dhe integrim në tregjet globale. Programi ynë synon pikërisht këto kompetenca bashkëkohore, shkathtësi dhe njohuri duke iu mundësuar studentëve të jenë pjesë aktive e zhvillimeve aktuale dhe të ardhshme në fushën e doganës, logjistikës, tregtisë së jashtme dhe transportit ndërkombëtar.